



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



E K S T R A K T

i procesverbalit të mbledhjes së njëmbëdhjetë të Komitetit për Komunitete, mbajtur më 12.12.2024, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Arton Brahim, Elmira Nikçi Rexha, Nenad Miladinovic, Kimeta Shok, Faton Marolli, Oktay Kurtesh, Adnan Ajeti.

Mungoi: Tiera Kasumi Berisha.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Muharrem Haziri - OSCE, Qefsere B. Veseli - ZKKK, Klaudia Mula - ZKKK, Arianita Beqa – Rraci - UNMIK.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e Komitetit znj. Mirsada Behluli me këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, znj. Jehona Lushaku Sadriu;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për muajin nëntor të ZKKK-ës për vitin 2024;
6. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre;
7. Të ndryshme.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pika e dytë

Ftesë për drejtoreshën e Drejtorisë së Arsimit, znj. Jehona Lushaku Sadriu.

Faqe 1 nga 4

Oktay Kurtesh: – tha se kërkesa për drejtoreshën e arsimit ka qenë për shkak se në rastin e kremtimit të ditës së flamurit më 28 Nëntor në shkollën “Meto Bajraktari” kemi pasur një rast, ku fëmijët që mbanin flamurin turk duke u vrrarë me shpata nga fëmijët që mbanin flamurin shqiptar, rast i cili është parë edhe në rrjetet sociale si në instagram, etj. Prandaj kërkoj që të merren masat ndaj drejtorit të shkollës në fjalë, si dhe mësimdhënësit që ka qenë aty ashtu siç janë marrë masat ndaj një mësimdhënësi në shkollën e komunitetit shqiptar kur mësimdhënësi ka marrë flamurin shqiptar dhe ka hedhur në shportë të mbeturinave.

Elmira Nikçi Rexha: - lidhur me rastin e cekur nga z. Kurtesh tha se me të marrë sms, jam ndier shumë keq kur në një moment të tillë komuniteti turk është ndier i fyer. Ajo në vazhdim tha se jam ndier keq edhe ndoshta nga një pamje e tillë ndoshta kur fëmijët janë përdorë për një shfaqje ku thellësisht e mendoj se nuk ka qenë ndonjë tendencë ndaj komunitetit turk që jeton në Komunën e Prishtinës. Andaj e besoj se akti i tillë duhet të trajtohet edhe konform ligjeve dhe rregulloreve që të merren masa, por një gjë më duhet ta them që në historinë dhe të kaluarën tonë nuk mundemi me e ndryshuar, pavarësisht se a pranohet prej dy grupeve të kombit turk dhe kombit shqiptar ajo histori d.m.th ka ndodhur edhe nuk mundet me u ndryshuar. Andaj akti si akt duhet me u trajtuar me marr masa, unë në emër të përfaqësimit Kuvendit Komunal i shpreh keqardhje komunitetit turk dhe po besoj se ky akt nuk duhet të përsëritet dhe masat duhet të ndërmerren.

Oktay Kurtesh: - tha se sa i përket historisë nuk e di që kanë luftuar prej Ballkanit kanë dalur dhe i kanë lënë kështu, as nuk kanë prerë, as nuk janë prerë.

Mirsada Behluli: – tha se përmes një përfaqësuesi të komunitetit turk kam dëgjuar për këtë ngjarje ku dhe më ka informuar se kryetari i Komunës z. Përparim Rama i ka kërkuar falje komunitetit turk për incidentin. Përmes mjeteve të informimit kam dëgjuar se drejtoresha e arsimit znj. Jehona Lushaku Sadriu ka kontaktuar me deputetët e komunitetit turk në Parlamentin e Kosovës. Ajo në vazhdim tha se ne si Komitet për Komunitete mund të japim një propozim që rastet e tilla të mos përsëriten më, të analizohet skenari për secilin kremtim.

Njëzëri u miratua propozimi nga ana e znj. Behluli.

Pika e tretë

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024.
Njëzëri u miratua Raporti vjetor i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2024.

Pika e katërt

Shqyrtimi dhe miratimi i Planit vjetor të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025.
Njëzëri u miratua Plani i vjetor i punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2025.

Pika e pestë

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës për muajin nëntor të ZKKK-ës për vitin 2024.

Faqe 2 nga 4

Klaudia Mula – të pranishmit i informoi se gjatë këtij muaji janë realizuar disa projekte të cilat janë të parapara me Planin e ZKKK-ës e ato janë:

- Projekti për shpërndarjen e pakove me mjete didaktike shkollore për nxënësit e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptas;
- Realizimi i projektit me shpërndarjen e pakove ushqimore për të gjitha familjet e komunitetit joshumicë që jetojnë në kushte të rënda ekonomike;
- Realizimi i projektit për ndarje të druve për ngrohje gjatë sezonit të dimrit nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale;
- Është dërguar lista e familjeve të cilat nuk janë përkrahur me dru zjarri.

Është dërguar tek kryetari dhe në Zyrën ligjore dhe është në proces të zbatimit. Këto janë pra disa nga projektet që janë realizuar gjatë kësaj periudhe, mirëpo ka edhe aktivitete tjera të cilat i kemi në bazë të planit.

Njëzëri u miratua Raporti i punës për muajin nëntor të ZKKK-ës 2024.

Pika e gjashtë

Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë lidhur me gjendjen e sigurisë në bashkësitë e tyre.

Oktay Kurtesh: – shtroi kërkesë lidhur me një familjar i cili i ka dy fëmijë në gara, ata janë Doan Karabeg dhe Baran Karabeg të cilët garojnë për kampionatin “Ermaks” në Itali dhe tregojnë rezultat të mirë sidomos Barani ka vendin e dytë, kërkojnë bursë nga Komuna e Prishtinës.

Kimeta Shok: – nuk kam se çka të them përveç listës me emrat e familjeve që presin për dru zjarri.

Mirsada Behluli: - tha se kryetari ka premtuar se do ta rregullojë këtë çështje, prandaj mbetet me prit se çka mund të bëhet.

Nenad Miladinovic: – tha se nuk dua të them asgjë nga mbledhja e kaluar përveç se çështja e mbeturinave është aktuale, të cilat ende janë aty, po ashtu edhe pastrimi i shtratit të lumit nuk ka ndodhur ende.

Pika e shtatë

Të ndryshme

Kimeta Shok: – propozoi që t’i dërgohet një kritikë drejtoreshës së arsimit për mospjesëmarrjen në takimin e sotëm.

Mirsada Behluli: – i shtroi pyetje të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve se si keni kaluar me distribuimin e këtyre pakove ushqimore.

Oktay Kurtesh: – lidhur me pakot ushqimore tha se nga komuniteti turk kanë marrë pesë familje.

Nenad Miladinovic: - tha se unë nuk kam qenë aty, atë punë e ka kryer Sllavica. Ai në vazhdim tha se informatën që e kam marr është se në listë kanë qenë familjet të cilat marrin ndihmë sociale, gjë për të cilën unë edhe më herët kam cekur se ato familje të cilat marrin ndihmë sociale mua nuk më interesojnë, pasi që ata njerëz të cilët marrin ndihmë sociale nuk ju takon të marrin kurrfarë ndihme tjetër sociale.

Faton Marolli: – tha se së pari dua të falënderoj ZKKK-ën, posaçërisht Klaudijën për punën që është duke e bërë, pra është një angazhim shumë i madh. Ai në vazhdim tha se tek komuniteti ynë ka më shumë familje që kanë nevojë për pako dhe ne e kemi oborrin ku distribuohen pakot.

Mirsada Behluli: - lidhur me distribuimin e pakove...po ndihmave tjera tha se do të ishte mirë që të organizohet shpërndarja ose në oborrin e komunës dhe t'i jepet një kohë më e gjatë komuniteteve, pra të caktohen terminet për secilën bashkësi.

Klaudia Mula: – sa i përket organizimit për shpërndarje të pakove nuk kemi pasur deri tani për shkak se kemi pasur bashkëpunim shumë të mirë me përfaqësuesit e komuniteteve, të cilët në mënyrë vullnetare e kanë organizuar mënyrën e shpërndarjes.

Pas ca diskutimeve dhe sugjerimesh Komiteti për Komunitete nxori këto:

REKOMANDIME

1. Komiteti për Komunitete dënon skenarin e paparashikuar që ka ndodhur në shkollën "Meto Bajraktari" në rastin e manifestimit të Ditës së Flamurit më 28 Nëntor, të organizuar përmes nxënësve të cilët kanë mbajtur flamurin turk janë sulmuar nga nxënësit të cilët kanë mbajtur flamurin shqiptar.
2. Të caktohet një vend i përshtatshëm zyrtar nga ana e komunës ku do të mund të bëhej shpërndarja e pakove ushqimore dhe higjienike për komunitetet joshumicë që jetojnë në Prishtinë.
3. Përfaqësuesi i komunitetit turk kërkon nga Drejtoria e Sportit që t'i jepë bursë për dy sportistët e komunitetit turk Doan dhe Baran Karabeg, të cilët morën pjesë në garat ndërkombëtare automobilistike në Itali dhe fituan vendin e dytë.

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Kryesuesja e Komitetit
Dr. Mirsada Behluli

